



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:041882
Datë: 08.04.2024
Numri i dokumentit: 05556926

CA.nr.3795/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Arsim Hamzaj dhe Halide Reka - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit-palës së mbrojtur A.....(T.....) M....., me vendbanim në rr. “Vojvode Putnika” pn, Mitrovicë e Veriut, të cilën e përfaqëson mbrojtësi i viktimave M..... P..... nga ZMNV, Prokuroria Themelore në Mitrovicë, kundër palës përgjegjëse M.... (B.....) D....., me vendbanim në rr. “V..... P.....” pn, Mitrovicë e Veriut, me objekt kontesti lëshimi i urdhërit mbrojtës, duke vendosur sipas ankesës së palës përgjegjëse kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.660/2024 të datës 21.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më **08.04.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET poshtë si e pas afatshme ankesa e palës përgjegjëse M..... (B.....) D....., ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.660/2024 të datës 21.02.2024.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin e atakuar C.nr.660/2024 të datës 21.02.2024 ka venosur në këtë mënyrë: I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesa e palës së mbrojtur A..... (T.....) M..... nga Mitrovica e Veriut dhe LËSHOHET urdhri për mbrojtje me këto masa: II. URDHËROHET pala përgjegjëse M..... (B.....) D..... nga Mitrovica e Veriut, që të ndërpres dhe të mos përsërisë asnjë veprim të dhunshëm ndaj palës së mbrojtur. III. URDHËROHET pala përgjegjëse, që të ndalojë që në mënyrë të drejtpërdrejtë, përmes personave të tretë apo çfarëdo lloj mënyre tjetër të komunikimit të ngacmojë, shqetësojë, manipulojë, ofendojë, kanosë, sulmojë përndjekë apo vëzhgojë palën e mbrojtur. IV. URDHËROHET pala përgjegjëse që të mos i afrohet palës së mbrojtur, në një distancë jo më afër se 100 metra nga banesa ku ajo jeton në rr. “Vojvode Putnika” pn, Mitrovicë e Veriut, ndërsa në vendet publike në një distancë prej 10 metra, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës lidhur me distancën

REFUZOHET SI E PABAZUAR. V. Kujdestaria e fëmive të mitur D..... Do..... dhe P..... D....., përkohësisht i besohen palës së mbrojtur- nënës A..... (T.....) M..... VI. Kontakti i palës përgjegjëse – babait M..... D..... me fëmijët e mitur D..... D..... dhe P..... D..... mbetet i lirë. VII. Detyrohet pala përgjegjëse M..... D....., që në emër të mbajtjes financiare për fëmijët e tyre të mitur t'i paguaj palës së mbrojtur A..... (T.....) M....., në xhirollogarinë e saj bankare me nr. 1503011002524368 në RBK, shumën prej 200.00 € në muaj, e cila pagesë do të bëhet për secilin muaj, me së largu deri me datën 05 të muajit vijues, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë, ndërsa pjesa tjetër e kësaj kërkesë mbi shumën e aprovuar, refuzohet si e pa bazuar; VIII. URDHEROHET pala përgjegjëse M..... (B.....) D..... nga Mitrovica e Veriut, që ta lëshojë menjëherë banesën e palës së mbrojtur në rr. “Vojvode Putnika” pn – Mitrovicë e Veriut. IX. URDHËROHET Stacioni Policor në Mitrovicën Veriore, që përmes zyrtarit policor të shoqërojë palën përgjegjëse M..... (B.....) D..... nga Mitrovica e Veriut, me rastin e largimit dhe marrjes së gjësendeve personale të tij nga banesa e palës së mbrojtur A.....(T.....) M....., në rr. “Vojvode Putnika” pn, Mitrovicë e Veriut, pas pranimit të vendimit nga ana e Stacionit Policor. X. Kohëzgjatja e urdhrit për mbrojtje caktohet në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj, dhe atë nga data 21.02.2024 e deri me 20.10.2024, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës lidhur me kohëzgjatjen e urdhrit përtej periudhës së aprovuar, REFUZOHET SI E PA BAZUAR. XI. Shkelja e Urdhrit mbrojtjes paraqet vepër penale dhe ndiqet sipas detyrës zyrtare (ex officio); XII. Urdhrin për Mbrojtje e ekzekuton Stacioni Policor në Mitrovicën e Veriut; XIII. Ankesa kundër këtij aktvendimi nuk e pezullon ekzekutimin e urdhrit për mbrojtje. XIII. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktvendimi pas afatit ligjor ka paraqitur ankesë pala përgjegjëse, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim si në të njejtën.

Pala e mbrojtur nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e palës përgjegjëse është e pas afatshme.

Gjykata e Apelit, duke vlerësuar fillimisht lejueshmërinë dhe afatshmërinë e ankesës së ushtruar, nga pala përgjegjëse konstatoi se e njëjta është ushtruar pas skadimit të afatit të paraparë ligjor prej 8 ditësh.

Nga shkresat e lëndës, konstatohet se Aktvendimin ankimor pala përgjegjëse e ka pranuar me datë 26.02.2024, kjo vërtetohet nga fletëkthesa e të njejtës datë, në të cilën figuron nënshkrimi i marrësit, ndërsa ankesa e ushtruar nga pala përgjegjëse ndaj aktvendimit të atakuar është dorëzuar me datë 06.03.2024 në gjykatën e shkallës së parë.

Nga momenti i pranimit të aktvendimit nga pala përgjegjëse, me datën 26.02.2024 e deri më datën e parashtrimit të ankesës të dorëzuar personalisht në gjykatën e shkallës së parë me datë 06.03.2024, kanë kaluar gjithsej 9 ditë, që nënkuptohet se ankesa është ushtruar 1 ditë pas kalimit të afatit të përcaktuar me ligj, neni 47.1 të Ligjit Nr.08/L-185, ngase si datë e fundit për ushtrimin e ankesës në rastin konkret ka qenë data 05.03.2024, e që bie ditë e marte.

Meqenëse, hudhjen poshtë të ankesës si të pas afatshme nuk e ka bërë gjykata e shkallës së parë, në kuptim të nenit 186 paragrafi 1 dhe 2, të LPK-së, sipas të cilit ankesa është e pas afatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj, si dhe neni 195, par.1, pika (a), ku përcaktohet që gjykata e ankimit ta hedhë poshtë ankesën si të vonuar, jo të plotë apo të palejueshme, si dhe neni 196, të LPK-së, ku është përcaktuar se: ankesën e vonuar, jo të plotë, apo të palejueshme, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë me aktvendim, po që se këtë nuk e ka bërë gjykata e shkallës së parë, siç është parashikuar në nenin 186 par.1 dhe 2 të LPK-së, gjykata e shkallës së dytë në kuptim të nenit 208 dhe 209, pika (a) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

CA.nr.3795/2024, me datë 08.04.2024

Kryetari i Kolegjit,
Ardian Ajvazi